



Kolegji Riinvest
Zyra për planifikim akademik

Etika Biznesore EKB0024

Data e aprovimit:	Data
Verzioni:	Verzion
ECTS:	6
Bartësi i lëndës:	Saxhide Mustafa
Email:	saxhide.mustafa@riinvest.net
Telefoni:	038 224 322

Hyrje:

Etika në biznes është një temë e vjetër të cilës shoqëria i ka kushtuar kujdesë. Si disipline shkencore është relativisht e re dhe hov të zhvillimit ka sidomos në shekullin e 19të. Në ditët e sotme, infrastruktura ligjore dhe rregullat e brendshme të kompanisë përcaktojnë sjelljet brenda biznesit dhe poashtu sjelljet me të gjithë akterët tjerë. Biznesi tani shikohet jo nga madhësia dhe profiti i tij por nga imazhi i tij, performanca e tij, reputacioni të cilin ai ka arritur në mjedisin ku vepron.

Qëllimet

Qëllimi i kësaj lënde është të njoftojë studentët me historikun e zhvillimit të etikës në biznes në vende të ndryshme. Zhvillimi i biznesin në mënyr etike në bazë ligjore duke iu shmangur, mënyrave joligjore dhe duke mësuar pasojat për këtë. Do të trajtojmë gjendjen lidhur me zhvillimin e biznesit në Kosovë, transparencën, korrupsionin, përgjegjësitë shoqërore të ndermarrjes, trajtimi etik i konsumtarëve, furnitoreve, diskriminimin në punë, zbatimin e kodit etik brenda kompanisë etj.

Rezultatet e pritura të lëndës

- Të identifikojnë, dhe vlerësojnë sjelljet etike dhe jo etike në biznes
Të dijnë dhe vlerësojnë dhe të ju shmangët format e diskriminimit në punë, pasojat e jo-transparencës, korrupsionit dhe konfliktin e interesit etj.
- Të kuptojnë dhe analizojnë involvimin e shtetit në biznes

Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	Definimi i konceptit të etikës, gjykimet normative, Morali dhe standardet morale	Ligjerata, ushtrime, diskutim i hapur
2	Etika në biznes, rëndësia dhe zhvillimi i pas viteve të 60-ta: Parimet kryesore etike në biznes	Ligjerata, ushtrime, diskutim

3	Etika e biznesit, rëndësia e studimit dhe përfitimet;	Ligjerata, ushtrime diskutim përmes shembujve të ndryshëm
4	Pjesëmarrësit në funksionimin e Biznesit; Etika e prodhimit për konsum dhe reklama	Ligjerata, ushtrime, diskutime të hapura përmes rasteve
5	Konfliktet në biznes, Biznesi dhe Profiti	Ligjerata, ushtrime dhe diskutim i rasteve të njohura në biznes
6	Diskriminimi në punë dhe aspektet etike të tij	Ligjerata, ushtrime, shembuj të ndryshëm.
7	Kolokfiumi I	Test me shkrim
8	Korrupsioni dhe pasojat e tij në ekonomi	Ligjerata, ushtrime, diskutim i hapur
9	Ligjeratë e organizuar me zyrtarët e Agjensionit kundër Korrupsionit	
10	Përgjegjësia shoqërore e korporatës	Diskutimi i rastit ENRON dhe ligjerat nga zyrtari i Rrjetit Përgjegjësia Shoqërore e Korporative në Kosovë
11	Përgjegjësia shoqërore e korporatës	Ligjeratë - Senton Kaçaniku- CEO Rrjeti i CSR Kososë.
12	Programet e menaxhimit etik - Rëndësia e kodit Etik në kompani	Ligjerata, ushtrime, prezantim i punimeve
13	Vendimarrja Etike në biznes	Ligjerata, ushtrime, prezantim i punimeve
14	Menaxhimi i rreziqeve dhe mundësia etike	Ligjerata ushtrime, prezantim i punimeve
15	Kollokfiumi II	Test me shkrim

Informata shtesë 1:

Gjatë ligjeratave studentet marrin njohurit e nevojshme teorike lidhur me sjelljet e etikës në punë. Meqenëse studentet obligohen që të ushtrorin të drejtën e praktikës profesionale në vitin e tretë të studimeve njohurit e marra mund hasin në praktikë. Gjatë ligjeratave ne poashtu kemi dy ligjerata me mysafir nga institucione relevante si Agjensioni Kundër Korrupsionit, dhe Rrjetit të përgjegjësive Sociale në Kosovë.

Informata shtesë 2:

Gjatë Ligjeratave praktikohet Kompjuteri për ligjeratat e përgaditura në PowerPoint, Video (dokumentar që zakonisht i paraqesin në orën e ushtrimeve, sidomos tek Rasti i korporatës Enron i cili lidhet me temën Përgjegjësia Sociale e Korporatës ose lidhur me temat tjera të lëndës), prezantimet e studentëve në PowerPoint.

Vlerësimi:

Nr.	Lloji Vlerësimit	Perqindja	Pershkrimi
1	Kolokvium	30	Testi i parë do të mbahet në javën e 7të ku përfshihen 5 pyetje dhe një ese
2	Kolokvium	30	Testi i dytë zhvillohet në javën e 15të dhe përfshihen 5 pyetje dhe një ese
			Detyra është obligim në këtë lëndë. Studenti nëse nuk e dorëzon punimin nuk mund ta marr notën maksimale. TEMAT: Temat dhe udhëzimet për punime PLAGJIATURA: Plagjiatura është vjedhje. Prandaj mos e bëni atë. Plagjiatura është përdorimi i ideve apo fjalëve të huaja pa i dhënë citim atij personi. Është e papranueshme që të përdoren fjalët direkte nga një burim pa i futur ato në thonjëza dhe pa cituar burimin në fusnotë. Gjithashtu, është e palejuar që të merrni idenë apo idetë nga një burim pa e cituar burimin në fusnotë. Sanksionimi është i rreptë dhe plagjiatura e

3	Detyra	30	qëllimshme sado e vogel mund te rezulton ne monimin e te drejtes për ta kaluar provimin në afatin përkatës. REFERENCAT: Siq u cek ne paragrafin paraprak, mbështetni pohimet and deklarimet në punimet tuaja me referenca përkatëse. Kjo është e domosdoshme. QARTËSIA:Keni kujdes që ta bëni të qartë tezën kryesore të punimit tuaj në pjesën hyrëse të përpilimit. Ju po përgatiteni të bëheni biznismenë/e, prandaj punimet tuaja duhet të përgatiten sikur të ishin plan biznesi. PËRQËNDRIMI: Qëndroni të përqëndruar në shkrim. Përpilimi i ideve tuaja duhet të vijon analitikisht dhe rrjedhmërisht. DREJTSHKRIMI: Shëndërimi i ideve në fjalë është një detyrë jo e lehtë. Prandaj, për ta arritur atë në mënyrë superiore kërkohet punë dhe redaktim. Së pari organizoni idetë që keni rreth punimit. Pastaj, bëni një përmbledhje të ideve, që vijon në mënyrë analitike. Përdorni titujt dhe nëntitujt që ta organizoni punimin në mënyrë të duhur. Kur të arrihet ajo, pastaj shkruani qartë, duke përdorur gjuhën e përsosur akademike dhe të biznesit. Fjalitë duhet të kenë kuptim, të jenë të shkurta dhe ti përcjellin rregullat gramatikore. Pas përfundimit të punimit, lexone atë disa herë dhe redaktone.
4	Pjesëmarrja	10	
5	Provimi Final	60	

Kushtet e përsëritjes:

Sipas rregullores së studentëve të nivelit BA të Kolegjit Riinvest, studenti ka të drejtë deri në tri herë të tentojë me kaluar lëndën. Nëse studenti nuk arrin që ta kalojë lëndën në mundësin e parë në fund të ligjëratave, atëherë vlerësimet e mëhershme (vijueshmëria, vlerësimet e kollokviumeve) gjatë ligjëratave i ruhen studentit deri në afatin e fundit që e ka për ta dhënë këtë lëndë. Nëse studenti nuk arrin që ta kalojë lëndën deri në mundësin e tretë që është në afatin e Shtatorit, atëherë studenti duhet ta përsëris komplet lëndën edhe një herë"

Burimet:

- Dr. Hysen Çela- Etika e Biznesore Raste studimore sipas temave të marra nga interneti nga institucione kredibile vendore dhe ndërkombetare.

Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	2	
Ushtrime:	1	
L+U:	60	
Seminar/praktike.:	12	
Studim i vazhdushem:	90	
Pregaditja e Provimit:	30	
Pjesemarrja ne teste:	2	
Pjesemarrja ne provimin final:	2	
Me profesorin dhe asistentin:	11	
Total Ore:	150	
ECTS:	6	